

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE DURRËS
NR.REP. 5740 NR.KOL. 3609



KONTRATË SHITJE
(për shitjen e kuotave të shoqërisë)

Sot me 09.12.2019 (nente dhjetor dymije e nentembedhjete), ditën e hene, para meje noterit publik ne qytetin e Shijakut, Ervis A.Klari, me zyre ne L.Popullore, u paraqiten:

Pala Shitese:

Z. Robert XHAFERRI, i biri i MALIQ-it, i lindur me date 23.07.1967 ne Shijak, Durres, me banim ne Shijak Rr.Lagja Popullore 002, Durres, identifikuar me leternjoftim ID nr. personal G70723001T, ne cilesine e Administratorit dhe te ortakut ne shoqerine "Johaniter" Shpk me NUIS K52108501I, **zotërues i 1-nje kuote në përqindje 33%**,

Z. Arjan XHAFERRI, i biri i MALIQ-it, i lindur me date 03.04.1977 ne Durres, me banim ne Shijak Rr.Lagja Popullore 002, Durres, identifikuar me leternjoftim ID nr. personal H70403016E, ne cilesine e ortakut ne shoqerine "Johaniter" Shpk me NUIS K52108501I, **zotërues i 1-nje kuote në përqindje 34%**,

Znj. Evelina REKA, e bija e Hysni-ut, lindur me 22.06.1967 ne Shijak, Durrës, me banim në Shijak Rr.Lagja Popullore 052, Shijak, Durrës, identifikuar me pasaporte me nr.personal G75622008I, ne cilesine e ortakut ne shoqerine "Johaniter" Shpk me NUIS K52108501I, **zotërues i 1-nje kuote në përqindje 33%** e perfaqesuar me prokure nga **Maksim Reka**, i biri i Ramazan-it, lindur me 03.12.1959 ne Shijak, Durres, me banim ne Shijak Rr.Lagja Popullore 052, Durres, identifikuar me Pasaporte ID nr. personal F91203005I, te cilet në përputhje me vendimin e Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë "JOHANITERI" SHPK, i dates 09.12.2019, i cili bashkangjitet kësaj Kontrate si Shtojca 1, kane vendosur shitjesn e kuotave te shoqerise "Johaniter" Shpk me NUIS K52108501I, e prej këtej e tutje e quajtur "Shitësi".

Pala Blerese:

Shoqeria "MGR" SHPK me NUIS L82010011T, me seli në Njesia Administrative Nr.5, Rruga Pjeter Bogdani, objekti Nr.3, Tirane, me Administrator Z.Endri Meksi, e përfaqësuar nga znj.Marsida Karabollaj, e bija e Agim-it, lindur me 19.09.1987, ne Tirane, me banim ne 1004 Njesia bashkiake nr. 1 Todi Shkurti 9 1 8, Tirane, me autorizim sipas vendimit te asamblese se Ortakeve te Shoqerise, date 09.12.2019 i cili bashkangjitet kësaj Kontrate si Shtojca 2 (i cili prej këtej e tutje do të emërtohet "Blerësi").

Palet e mesiperme jane madhore e me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, te cilet me deshire te plote kerkuan perpilimin e kontrates per shitjen e kuotave te shoqerise si vijon:

Baza ligjore: Neni 705 e vijues te Kodit Civil te RSH, neni 68 e vijues te ligjit 9901, date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" i ndryshuar, ligji nr. 110/2018 "Per noterine", neni 43 e vijues i ligjit nr.9723, datë 3.5.2007, "Per qendren kombetare te regjistrimit", i ndryshuar, Vendimin nr.2, date 09.12.2019, i Shoqerise "Johaniter" Shpk., Vendim date 09.12.2019 i Asamblese se Ortakeve te Shoqerise "MGR" Shpk.

Neni 1

Objekti i kontratës dhe kushtet paraprake

Shitësi i shet Blerësit dhe Blerësi blen nga Shitësi kuotat e shoqërisë "JOHANITERI" SHPK me pjesëmarrje 100% dhe çdo të drejte qe ka lidhje me to sipas çmimit dhe kushteve të parashikuara në këtë kontratë.

Blerësi, njeh faktin se kjo shoqëri ka një detyrim ndaj organeve tatimore në vlerën e 2.100.000 (një milion e një qind mijë) Lekë. Shitësit deklarojnë se nuk kanë detyrime të tjera si ndaj organeve publike ashtu edhe ndaj subjekteve të tjera fizike apo private. Në rast të kundërt shitësit deklarojnë se do të përgjigjen solidarisht për këto detyrime.

Blerësi njeh, gjithashtu dhe faktin se me Urdhërit Nr.20252 Prot, datë 03.05.2016, protokolluar nga QKB me Nr. 959 Prot., datë 09.05.2016 "Për Vënien e Sekuestros Konservative", lëshuar nga Shoqëria Përmbartimore "Sherbimi Përmbartimor STAR", drejtuar QKB, ku është urdhëruar: Vendosja e masës sekuestro konservative në kuotat/aktivet e ortakut Robert Xhaferri në subjektin "JOHANITERI".

Blerësi është gjithashtu edhe në dijeni të faktit që me vendimin nr. 1139 (11-2016-3248), datë 14.7.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës është vendosur anulimi i urdhërit të ekzekutimit nr.1928, datë 29.3.2016, si edhe janë anuluar të gjitha veprimet përmbartimore të kryera nga shërbimi përmbartimor "Star" shpk për ekzekutimin e këtij urdhëri. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr.10-2017-1579/657, datë 20.6.2017 të Gjykatës së Apelit Durrës, duke marrë kështu formë të prerë.

Blerësi është në dijeni edhe të faktit se shoqëria "Johaniteri" shpk ka detyrime në formën e gjobave administrative nga Qendra Kombëtare e regjistrimit dhe i njeh ato.

Blerësi deklaron se regjistrimi i kësaj kontrate për pasqyrimin e faktit të kalimit të kuotave nga shitësi tek blerësi, në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit do të bëhet mbas zbatimit të vendimit gjyqësor, duke hequr sekuestron e vendosur nga shërbimi përmbartimor, si edhe mbas shlyerjes totale të gjobave administrative kundrejt QKB-së.

Neni 2

Çmimi i blerjes

Shitësi i shet Blerësit dhe Blerësi blen nga Shitësi kuotat e shoqërisë "JOHANITERI" SHPK me pjesëmarrje 100% përkundërt çmimit 451400,00 (katerqind e pesedhjetë e një mijë e katerqind) Lekë, i cili paguhet menjëherë në momentin e lidhjes së kësaj kontrate.

Çmimi i mësipërm do të ndahet, në përputhje me pjesëmarrjet në përqindje të ortakeve, si më poshtë:

Z. Robert Xhaferri, do t'i paguhet shuma 148962,00 (njëqind e dyzet e tete mijë e nente qind e gjashtedhjetë e dy) Lekë.

Z. Arjan Xhaferri, do t'i paguhet shuma 153476,00 (njëqind e pesedhjetë e tre mijë e kater qind e shtatedhjetë e gjashtë) Lekë.

Znj. Evelina Reka, do t'i paguhet shuma 148962,00 (njëqind e dyzet e tete mijë e nente qind e gjashtedhjetë e dy) Lekë.

Neni 3

Kushtet e kontratës

Nëse vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit për çështjen në të cilën "JOHANITERI" SHPK është në proces nuk merret në favorin e saj, MGR rezervon të drejtën të zgjidhe këte kontratë, dhe palët do të kthehen në gjendjen e mëparshme, duke bërë sipas rastit transferimin e kuotave, rikthimin e shumave përkatëse dhe të konsiderojë këte kontrate sikur nuk është lidhur.

Neni 4

Kthimi i palëve në gjendjen e mëparshme

Në rast të vërtetimit të kushtit të përcaktuar në nenin 4, shitësit janë të detyruar që të kthejnë shumën prej 451400,00 (njëqind mijë) lekë që përfaqëson çmimin e blerjes së kuotave, në shoqërinë Johaniteri sh.p.k..

Blerësi është i detyruar që më vërtetimin e kushtit të përcaktuar në nenin 4, të kthejë pronësinë e kuotave të shoqërisë "Johaniteri" shpk.



2/3



Neni 5

Zgjidhja e mosmarreveshjeve

Në rast të çfarëdo mosmarreveshje ndërmjet palëve që ka të bëjë me interpretimin ose zbatimin e kësaj Kontrate do të zbatohen dispozitat përkatëse të Kodit Civil.

Kontrata pasi u redaktuar në 4-kopje origjinale me vlerë të njejtë me nga tre flete secila, lexohet me ze të lartë dhe palet, pasi shprehen se e kuptojnë dhe e pranojnë atë sepse pasqyron vullnetin e tyre të lire, e nënshkruajnë atë rregullisht në praninë time Noterit. Për sa sipër une noteri vërtetoj.

Pala Shitese

Ortakët e shoqërisë "Johaniter" Shpk

1. Robert XHAFERRI, *Robert Xhaferr*
2. Arjan XHAFERRI *Arjan Xhaferr*
3. Evelina REKA, e përfaqësuar me prokurë nga Z. Maksim Reka

Maksim Reka

Pala Blerese

Shoqëria "MGR" SHPK

E përfaqësuar nga Znj. Marsida Karabollaj

Marsida Karabollaj

NOTER
ERVIS KLARI



PROKURE E POSAÇME

Sot, me date 24.11.2019 (njetzet e kater Nentor dymije e nentembedhjete), ditën e diel, para meje noterit **ERVIS A.KLARI**, me zyre ne lagjja "Popullore", Shijak, Durres, u paraqit personalisht:

Znj.EVELINA REKA, atesia HYSNI, e lindur me date 22.06.1967 ne Shijak, Durres, banuese ne lagjja "Popullore" Shijak, Durres, e identifikuar me pasaporte nr.personal G75622008I leshuar me date 03.09.2010.

Madhore, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, e cila me deshire te plote dhe vullnet te lire, me kerkoj perpilimin e kesaj prokure te posaçme si vijon:

Baza ligjore: nenet 70 e vijues te Kodit Civil Shqiptar dhe Ligji nr.110/2018 date 20.12.2018 "Per noterine" ne RSH.

Deklaroj se emerogj dhe caktoj si perfaqesuesin tim te posaçem bashkeshortin tim Z.MAKSIM REKA, i biri i RAMAZAN-it, i lindur me 03.12.1959 ne Shijak, Durres, banues ne lagjja "Popullore" Shijak, Durres, i identifikuar me pasaporte nr.personal F91203005I leshuar me 25.07.2018.

Perfaqesuesi im ka te gjitha te drejtat dhe tagrat ligjore, ne menyre qe ne emer dhe per llogarine time si ortak e shoqerise "JOHANITERI" shpk me NUIS K52108501I, te kryeje veprimet si vijon:

- Te me perfaqesoje prane zyrave te QKB-se, prane zyrave te QKL-se, Drejtorise se Tatimeve, apo prane çdo zyre tjeter te administrates per te nenshkruar, terhequr, dorezuar, dokumente ne emrin tim si ortak i "JOHANITERI" shpk.
- Te nenshkruaje Aktin e Themelimit dhe Statutin e Shoqerise "JOHANITERI" shpk, ne te cilen une jam ne cilesine e ortakut.
- Te realizoje dhe te nenshkruaje Vendimin e Asamblese se Ortakeve te Shoqerise per shitjen e kuotave, gjithashtu te nenshkruaje ne emrin tim ne çdo lloj vendimi tjeter.
- Ai gjithashtu eshte i autorizuar te nenshkruaje perpara noterit ne Kontraten per Shitjen e Kuotave te mija si ortak i shoqerise "JOHANITERI" shpk, te percaktoje kushtet e kontrates, si dhe terheqe çmimin e shitjes se kuotave.
- Te depozitoje Vendimin e Asamblese dhe Kontraten e Shitjes se Kuotave prane QKB-se per te realizuar ndryshimet perkatese.

Perfaqesuesi im eshte i autorizuar te kryeje çdo lloj veprimi tjeter, qe nuk eshte cilesuar shprehimisht, por qe eshte ne funksion te realizimit te qellimit te prokures.

Te gjitha veprimet e ligjshme te kryera nga perfaqesuesi im per sa me sipër, do te konsiderohen si te kryera nge vete une.

Prokura eshte pa afat, deri sa nuk revokohet me akt noterial.

Prokura pasi u lexua, u konfirmua e hartuar sipas vullnetit te te perfaqesuarit, dhe nenshkruhet prej tij ne pranine time noterit, ne zyren time noteriale.

Une noterit e vertetoj kete akt ne baze te ligjit.

I PERFAQESUARI
EVELINA REKA

NOTER
ERVIS KLARI



VENDIM I ASAMBLESE SE ORTAKEVE TE SHOQERISE

“JOHANITERI“ SHPK

Nr. 2

Ne Shijak sot me dt.09/12/2019, në selinë e Shoqërisë “JOHANITERI“SHPK, person juridik me NUIS K52108501I, me adresë Shijak, Durrës u mbajt mbledhja e asamblesë së kësaj shoqërie dhe janë të pranishëm ortakët e kësaj shoqërie si më poshtë:

1. Z. **Robert Xhaferri**, i datëlindjes 23.07.1967, me zotesi te plote juridike e per te vepruar, mbajtës i Letërnjoftimit nr.personal G70723001T, zotërues i një kuote me pjesëmarrje 33%.

2. Z.**Arjan Xhaferri** i datëlindjes 03.04.1977, me zotesi te plote juridike e per te vepruar, mbajtës i Letërnjoftimit nr.personal H70403016E, zotërues i një kuote me pjesëmarrje 34%.

2. **Znj. Evelina Reka** e datëlindjes 22.06.1967, me zotesi te plote juridike e per te vepruar, mbajtëse e Letërnjoftimit nr.personal G75622008I, zotëruese e një kuote me pjesëmarrje 33%, e perfagesuar me prokure Rep. 5476 Kol.3433 me date 24.11.2019, perpiluar ne zyren noteriale te Noter Ervis Klari, me seli ne Shijak, nga z.MAKSIM REKA, i datelindjes 03.12.1959, me zotesi te plote juridike e per te vepruar, mbajtës i Letërnjoftimit nr.personal F91203005I,

Administratori Robert Xhaferri e deklaroi mbedhjen te hapur me ketë

REND DITE: Shqyrtimi i ofertës për shitjen tek të tretet të kuotave të shoqërisë me pjesëmarrje 100%
Shkarkimin e administratorit z. Robert Xhaferri
Emerimin e administratorit znj. Marsida Karabollaj

Fillon shqyrtimi i çështjeve objekt i rendit të ditës

RELATON ADMINISTRATORI DHE ORTAKU Robert Xhaferri

Në selinë e shoqërisë është depozituar një ofertë që ka të bëjë me shitjen e të treja kuotave që ortakët kanë në shoqëri, kundrejt shoqërisë “MGR” shpk.

Në lidhje me pikën e parë të rendit të ditës shprehem dakort dhe në këtë rast do të lidhet kontrata.

Gjithashtu jam dakort që kuota ime por edhe ortakëve të tjerë të shiten kundrejt cmimtotal prej 451400,00 lekë.

Kontrata për shitjen e kuotave propozohet të lidhet me kushtin që nëse në Gjykatën Administrative të Apelit, për çështjen në të cilën ne jemi në proces me Autoritetin e Mediave Audiovizive (AMA), nuk është në favorin e shoqërisë, atëherë të gjitha palët do të kthehen në gjendjen e mëparshme kontrata që do të lidhim me “MGR”SHPK për shitjen e kuotave të shoqërisë do të konsiderohet sikur nuk është lidhur.

Për më tepër ftoj ortakët e tjerë të shprehet në lidhje me këtë ofertë.

DISKUTON ORTAKU Arjan Xhaferri:

Jam dakort me propozimet, dhe për shitjen e kuotës sime me pjesëmarrje 34% si edhe me kushtet e tjera.

DISKUTON ORTAKU Evelina Reka:

Jam dakort me propozimet, dhe për shitjen e kuotës sime me pjesëmarrje 33% si edhe me kushtet e tjera.

Ne perfundim Asambleja e Ortakeve te shoqerise "JOHANITERI" SHPK me unanimitet

V E N D O S I :

1. Te lejoje transferimin (shitjen) e të treja kuotave me pjesëmarrje 100%, konkretisht 33% nga ortaku Robert Xhaferri, 34% nga ortaku Arjan Xhaferri, 33% nga ortakia Evelina Reka përkundrejt vlerës totale prej 451400,00 Lek, sipas kushteve të propozuara nga "MGR" SHPK.
2. Te kryhen veprimet juridike per nënshkrimin e kontratave përkatëse.
3. Te shkarkoje administratorin z. Robert Xhaferri.
4. Te emeroje administrator te shoqerise znj. Marsida Karabollaj per periudhen 09/12/2019-08/12/2024.
5. Ngarkohet znj. Marsida Karabollaj te kryeje formalitetet perkatese per depozitimimin e ketij vendimi ne regjistrin tregetar Tirane, kontratës përkatëse dhe cdo fomalitetit tjetër të kërkuar nga ligji prane Qendrës Kombëtare të Biznesit Tiranë.

Me pas Administratori e deklaroi mbledhjen te mbylluar.

ORTAKET E SHOQERISE "JOHANITERI" SHPK

ROBERT XHAFERRI

Robert Xhaferri

ARJAN XHAFERRI

ARJAN Xhaferri

EVELINA REKA

E perfaqesuar me prokure nga
MAKSIM REKA

Maksim Reka

"JOHANITERI" Sh.p.k
Shërbime Televizioni Privat
Shijak - Durrës
K32108301L

VENDIM I ASAMBLESE SE ORTAKEVE TE SHOQERISE
"MGR" SHPK

Ne Tiranë sot me dt.09/12/2019, në selinë e Shoqërisë "MGR" SHPK, person juridik me NUIS L82010011T, me adresë rruga "Pjetër Bogdani", objekti nr.3, Njesia Administrative nr.5, Tiranë u mbajt mbledhja e Asamblesë së kësaj shoqërie dhe është i pranishëm ortaku i vetëm i kësaj shoqërie:

Endri Meksi, i datëlindjes 1.7.1979, me zotësi të plote juridike e për të vepruar, mbajtës i Letërnjoftimit nr.025462665 ortaku i vetëm i shoqërisë me pjesëmarrje 100%.

Në cilësinë edhe të Administratorit të shoqërisë, Endri Meksi e deklaron mbedhjen te hapur me këtë

REND DITE: Blerja e të gjitha kuotave të shoqërisë "JOHANITERI" SHPK

Shoqërisë "JOHANITERI" SHPK do t'i propozohet një ofertë nga "MGR" SHPK për blerjen e të treja kuotave, me pjesëmarrje 100% me çmimin 451400,00 Lekë, që do të paguhet menjëherë me lidhjen e kontratës. Jam i vetëdijshëm që shoqëria Johaniteri shpk ka lidhur një kontratë për përdorim sinjali me shoqërinë Tema TV shpk, kontratë të cilën e njoh dhe do e respektoj. Pjesë e kontratës do të rregullohen edhe marrdhënie të tjera juridike sipas projektit të paraqitur.

Kontrata për shitjen e kuotave propozohet të lidhet me kushtin që nëse në Gjykatën Administrative të Apelit, për çështjen në të cilën Johaniteri shpk është në proces me Autoritetin e Mediave Audiovizive (AMA), nuk është në favorin e saj, atëherë të gjitha palët do të kthehen në gjendjen e mëparshme kontrata për shitjen e kuotave të shoqërisë do të konsiderohet sikur nuk është lidhur.

Ne perfundim Ortaku i vetëm i shoqërisë "MGR" SHPK

VENDOSI:

1. Te lejoje blerjen e të treja kuotave me pjesëmarrje 100%, konkretisht 33% nga ortaku Robert Xhaferri, 34% nga ortaku Arjan Xhaferri, 33% nga ortakia Evelina Reka përkundrejt vlerës totale prej 451400 Lekë, sipas kushteve të caktuara në këtë mbledhje.
2. Te kryhen veprimet juridike për kalimin e pronësive së kuotave sipas këtij vendimi.
3. Të kryhen të gjitha veprimet për lidhjen e kontratës sipas projektit të paraqitur.
4. Te autorizojë znj. Marsida Karabollaj, e datëlindjes 19.09.1987, me zotësi të plote juridike e për të vepruar, mbajtës i Letërnjoftimit nr.029055078, të nënshkruajë kontratën e shitblerjes së kuotave.
5. Ngarkohet znj. Marsida Karabollaj të kryejë formalitetet përkatëse për depozitimin e këtij vendimi në regjistrin tregëtar Tiranë, kontratës përkatëse dhe cdo formalitetit tjetër të kërkuar nga ligji pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit Tiranë.

ORTAKU I SHOQERISE "MGR" SHPK

Endri Meksi
